




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. i faq 02
 Broj stranica
 Nr. pages

Nr. Prot. 01-3582/15
 Br. Prot. 01-3582/15
 Prot. No.
 Data 26.10.2015
 Datum

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	22.10.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-03-02/1890/15
PËR/ZA/TO:	z. Naser Shatrolli, Zyrtar i Lartë për Diplomaci Kulturore në Ministrinë e Kulturës Rinisës Rinisë dhe Sportit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Shatrolli,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, (neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë Opinion :

O P I N I O N

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Naser Shatrolli – Zyrtar i Lartë për Diplomaci Kulturore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me numër të protokollit 03-02-1890/15, në të cilin z. Shatrolli ka kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit ku si autor i skenarit ka konkuruar për subvencionim për film të shkurtër artistik në Qendrën Kinetografike të Kosovës.

Në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se “konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”, ndërsa neni 4 i këtij ligji ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, të cilët i nënshtrohen këtij ligji.

Rrjedhimisht, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, nuk ka konflikt interesi në rast të përfitimit të subvencionit për realizim të filmit të shkurtër artistik në Qendrën Kinetografike të Kosovës.

Ligji për Kinematografinë nr.2004/22 në nenin 33 (paragrafi 2), të këtij ligji ka përcaktuar të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs në të cilin shprehimisht thuhet: “Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë të gjithë personat juridikë, vendës ose të huaj të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit (producentët filmikë), si dhe kineastët me statusin e artistit të lirë, nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe. Nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs punëtorët e QKK dhe anëtarët e Këshillit drejtues”.

Rregullorja nr.02.2013 për Subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës ka përcaktuar Institucionet, organizatat dhe individët të cilët mund të subvencionohen nga MKRS, kriteret për të drejtën e subvencionimit, mënyrat e aplikimit, procesin prej aplikimit e deri te mbyllja e projekteve filmike, trajtimi i dokumentacionit, emërimi i jurisë, kufizimet në pjesëmarrje në konkurim, atributet e QKK – së, shpërndarja e fitimeve nga eksploatimi i veprës filmike dhe obligimet e producentit.

Mirëpo, meqenëse ju nuk hyni në kategorinë zyrtarëve të lartë publik të paraparë në nenin 4 të Ligjit PKI, ne ju sugjerojmë që të veproni konform Rregullores nr. 04/15 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht, në pajtim me nenin 16 të kësaj rregulloreje, e cila ka parashikuar dispozitat si më poshtë:

Angazhimi i nëpunësit civil jashtë institucionit

1. Me veprimtari të jashtme të nëpunësit civil kuptojmë çdo lloj angazhimi të rregullt ose të kohë pas kohshëm jashtë institucionit me pagesë ose pa pagesë.

2. Nëpunësi civil nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare dhe që cenon në çfarëdo mënyre, realizimin e objektivave të institucionit.

3. Nëpunësi civil për angazhimin e jashtëm duhet t'i njoftoj paraprakisht udhëheqësin drejtues dhe njësinë e personelit.

4. Angazhimi i nëpunësit civil në kuadër të veprimtarive sindikale ose të përfaqësimit të nëpunësve civil ose veprimtaritë mësimdhënëse, hulumtuese dhe trajnuese, janë të lejueshme kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës dhe nuk bien ndesh me natyrën e punës.

Gjatë ushtrimit të funksionit publik, kur keni dyshimeve për situatë të konfliktit të interesit mund të konsultoheni me Zyrën Ligjore në institucionin tuaj.

Me respekt!

* DAKOCC